



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, datë 28.07.2016

PËR

DISA NDRYSHIME NË LEJEN E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “REHABILITIMI I BREGUT TË LIQENIT TË OHRIT DHE GJELBËRIM PËRGJATË SEGMENTIT LIN-POGRADEC”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Mbi disa ndryshime në projektin “Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërim përgjatë segmentit Lin-Pogradec”, me subjekt kërkues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit të plotë të pronësisë;
 - b) marrjes së autorizimit nga Këshilli Kombëtar i Ujit;
 - c) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

